



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE

---

Mbështetur në Ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH”, VKM nr. 780 datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë” botuar në Fletoren Zyrtare nr. 189:

**Njoftohen të gjithë studentët se deri ne daten 15 Nëntor 2021 nga ora 10:00 -12:00 nga e hëna në të premte fillon mbledhja e dokumentacionit** pranë zyrës së Financës në ISE, sipas kategorive të shtresave sociale të përcaktuara në VKM e sipërpërmendur:

Dokumentacioni i kërkuar sipas kategorive:

1- Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë,

**Studentë me statusin invalid, paraplegjik dhe tetraplegjik, studentët që nuk shikojnë, nuk dëgjojnë:**

- Fotokope e noterizuar të Vërtetitmit të K.M.C.A.P-së (Komisionit të caktimit të aftësisë për punë) ose K.MP.V-së (Komisionit të përcaktimit të verbërisë);
- Fotokopje e noterizuar së Statusit paraplegjik/tetraplegjik/ Librezsë së Verbërisë;
- Vërtetim original nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore për masën e pagesës së pensionit të paaftësisë/verbërisë që merr student;
- Vërtetim nga Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë ose Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë ose Shoqatat e tjera përkatëse;
- Çertifikatë familjare dhe fotokopje të kartës së identitetit të studentit;
- Vërtetim Studenti.

2- Studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësiti e vetëqeverisjes vendore:

- Kopje origjinale ose fotokopje e noterizuar e Vërtetitmit të K.M.C.A.P-së (Komisionit të caktimit të aftësisë për punë) për invalidët e punës/ paraplegjik/ tetraplegjik;
- Vërtetim nga shoqata e Invalidëve të Punës së rrethit përkatës ;
- Fotokopje me vulë të njomë të Dëshmisë së Invalidit të Punës;
- Vërtetim original nga Instituti I Sigurimeve Shoqërore për pagesën e pensionit të invaliditetit;
- Vërtetim origjinal nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore për masën e ndihmës ekonomike të plotë/pjesshme që përfiton familja e studentit si familje në nevojë.

- Ose
  - Për masën e ndihmës sociale që përfiton prindi invalid;
  - Çertifikatë familjare që vërteton lidhjen e studentit me prindin invalid dhe fotokopje të kartës së identitetit të studentit dhe të prindit invalid;
  - Vërtetim Studenti.
- 3- Studentët, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore:
- Çertifikatë familjare që vërteton lidhjen e studentit me kryefamiljarin familja e të cilit përfiton ndihmë ekonomike të plotë/pjesshme nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore;
  - Vërtetim original nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore për masën e ndihmës ekonomike të plotë/pjesshme që përfiton familja e studentit (ku të jetë i shënuar numri i dosjes dhe shuma e ndihmës ekonomike me shifra dhe fjalë dhe masa e ndihmës ekonomike - e plotë apo e pjesshme dhe të ketë gjithashtu numër protokoll, i nënshkruar nga përgjegjësi i seksionit të ndihmës ekonomike dhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe me vulë të njomë;
  - Fotokopje të kartës së identitetit të studentit;
  - Vërtetim Studenti.
- 4- Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;
- Çertifikatë familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit të studentit;
  - Çertifikatë e ndarjes nga jeta e prindit;
  - Vërtetim për të ardhurat vjetore të familjes;
  - Vërtetim nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore që familja përfiton ose jo ndihmë ekonomike si familje në nevojë;
  - Vërtetim që tregon të ardhurat nga punësimi i familjarëve në moshë madhore;
  - Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore që asnjë nga familjarët e studentit (mbi 18 vjeç) nuk ushtrojnë aktivitet privat;
  - Vërtetim nëse prindi apo pjesëtarët e tjerë të familjes mbi 18 vjeç janë të regjistruar si punëkërkuar të papunë – pranë Zyrës së Punës – kur nuk janë të punësuar;
  - Vërtetim familjarisht nga Instituti I Sigurimeve Shoqërore nëse përfitojnë pension apo jo;
  - Vërtetim nëse familjarët kanë tokë ose pasuri të paluajtshme fitimprurëse në pronësi;
  - Vërtetim Studenti.
- 5- Studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç
- Çertifikatë familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit të studentit;
  - Çertifikatë e ndarjes nga jeta të të dy prindërve;
  - Fotokopje të noterizuar të statusit të jetimit të përfituar nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë;
  - Vërtetim nga Shoqata e Jetimëve të Shqipërisë;
  - Vërtetim Studenti.

- 6- Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë:
- Kur student ka humbur përgjegjësinë prindërore nga të dy prindërit:
    - Çertifikatë familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit të studentit;
    - Kopje origjinale ose fotokopje e noterizuar e Vendimit të gjykatës i formës së prerë që student i ka humbur përgjegjësinë prindërore nga të dy prindërit ;
    - Vërtetim Studenti.
  - Kur student ka humbur përgjegjësinë prindërore nga njëri prind dhe prindi tjetër nuk jeton:
    - Çertifikatë familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit të studentit;
    - Kopje origjinale ose fotokopje e noterizuar e Vendimit të gjykatës i formës së prerë që student i ka humbur përgjegjësinë prindërore nga njëri prind;
    - Vërtetim Studenti;
    - Çertifikatë e ndarjes nga jeta të prindit tjetër.
- 7- Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore;
- Çertifikatë familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit të studentit;
  - Vërtetim nga Minsitria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ose Ministria e Brendshme që kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore;
  - Vërtetim Studenti.
- 8- Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria/institucioni përgjegjës;
- Çertifikatë familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit të studentit;
  - Çertifikatë e ndarjes nga jeta të prindit që ka humbur jetën në krye të detyrës/për shkak të detyrës;
  - Vërtetim konifrmimi nga Ministria përkatëse;
  - Vërtetim Studenti.
- 9- Studentët romë dhe ballkano-egjiptianë, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale;
- Fotokopje e kartës së identitetit të studentit;
  - Vërtetim anëtarësië nga shoqata përkatëse;
  - Vërtetim konifrmimi nga Ministria Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;
  - Vërtetim Studenti.
- 10- Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
- Çertifikatë familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit të studentit

- Dëshmi penaliteti për prindi ish të përndjekur politik ose vërtetim për kohën e dënimit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.
- Vërtetim I statusit të prindit ish të përndjekur dënuar/ politik
- Vërtetim Studenti.

11- Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë);

12- Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të regjistruar në vitin e parë pas të parit dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin akademik paraardhës.

Pas dorëzimit të dokumentacionit, sipas VKM të sipërpërmendur vendimi për studentët që do të përfitojnë reduktim të tarifës së Shkollimit do të merret nga Bordi i Administrimit.